V E N D I M
Nr.94, datë 25.2.1999

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.370, DATË 8.8.1994 "PËR CAKTIMIN E TARIFAVE TË REGJISTRIMIT TË BARNAVE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, të nenit 13 të ligjit nr.7815, datë 20.4.1994 "Për barnat" dhe të pikës 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.424, datë 9.7.1998 "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore", me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.370, datë 8.8.1994 "Për caktimin e tarifave të regjistrimit të barnave", shfuqizohet.

2. Tarifat e regjistrimit të barnave caktohen nga Ministria e Shëndetësisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko